

**Trepça Shoqëri Aksionare**  
**Trepça Joint Stock Companies**  
**Trepça Deoničarsko Društvo**

Nr. 7133 Data. 29.12.2022  
Mitrovicë Mitrovica



Republika e Kosovës  
Republika Kosova-Republic of Kosovo  
*Qeveria - Vlada - Government*

Trepça Shoqëri Aksionare  
Trepça Deoničarsko Društvo / Trepça Joint Stock Company



## RREGULLORE PËR NDIHMA SOLIDARE PËR PUNËTORET E TREPÇA SH.A

Mitrovicë, më 28.12.2022



Në bazë të nenit 95 paragrafi 1 të Ligjit Nr.03/L-212 të Punës, nenit 3 paragrafi 1.4 i Ligjit Nr.05/L-120 për Trepçën, Ligjit NR. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike, nenit 20 të Ligjit nr.04/L-111 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.03/L-087 për Ndërmarrjet Publike, nenit 130 të Ligjit nr.06/L-016 për Shoqëritë Tregtare dhe nenit 8 të Statutit të Trepça Sh. A, Bordi Mbikëqyrës i Trepça Sh. A ., në mbledhjen e mbajtur më 28.12.2022, miraton këtë:

## **RREGULLORE PËR NDIHMA SOLIDARE PËR PUNËTORËT E “TREPÇA” SH.A.**

### **Neni 1**

#### **Qëllimi**

Kjo rregullore ka për qëllim të përcaktoj dhënien e ndihmave solidare për punonjësit e “Trepça” Sh.A.

### **Neni 2**

Punëdhënësi do të paguaj ndihma solidare financiare, pa obligim kthimi, në rastet e fatkeqësisë natyrore përkatësisht vdekjes së punonjësit dhe kompensimin e shpenzimeve të kujdesit shëndetësor të punonjësve me sëmundje të rënda.

Për këto raste ndihma solidare për të punësuarit përcaktohet maksimalisht në vlerë prej 1000 (një mijë) €.

### Neni 3

Në rast të vdekjes së anëtarit të ngushtë të familjes së punonjësit (bashkëshortes ose fëmijës) ndihma solidare përcaktohet maksimalisht në vlerë prej 500 (pesëqind) €.

### Neni 4

Varësisht nga gjendja financiare e shoqërisë dhe pas aprovimit nga Bordi Mbikëqyrës i “Trepça” Sh .A., punonjësve të shoqërisë mund t’u ndahen individualisht mjete financiare sipas rasteve në shuma më të mëdha se 1000 (një mijë) Euro.

### Neni 5

#### Dispozitat përfundimtare

Kjo Rregullore për ndihma solidare për punonjësit e “Trepça” Sh.A. hyn në fuqi në ditën e aprovimit dhe e njëjta do te publikohet në web-faqen zyrtare.

Kryesuesi i Bordit Mbikëqyrës të “Trepça” Sh.A.



Dr.Sc. Bahri Hyseni

